



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 271/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret: Muharrem Shala Kryesues, Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e parashtruar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Pejë paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shkak të mungesës së votave për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në seancën e panelit të mbajtur me 11.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Pejë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.06.2014, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Pejë, në të cilën pretendohet se Shtabi i degës të LDK-së në Pejë kanë vreytur se në rezultatet preliminare të prezantuara në web faqen zyrtare të KQZ-së në Qendrën e Votimit 1704C/01 në Pejë janë regjistruar 00 vota për LDK, kurse vëzhguesi i procesit Zgjedhor të LDK-së Durim Balaj ka regjistruar në formularin e raportit për vëzhgim 93 vota ku subjekti politik Bošnjaka Stranka që është e renditur afër LDK-se i janë bartur votat e LDK-së, thuhet në pretendimet e ankimore të LDK-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur kohen e formularit të raportit të vëzhgimit si dhe raportin preliminar nga web faqja e KQZ.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminar i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrohet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas Nenit 102.1 të LZP-së parasheh se “Çdo anëtarë i komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje të Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në përputhje me këtë ligj”. Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga vëzhguesi i LDK-së që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtror ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërsënuar dhe në kuptim të Nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 271/2014 më datën 11.06.2014

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.